

VENDIM
Nr. 712, datë 9.9.2020

**PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË TIRANË, TË NJËSISË
ADMINISTRATIVE TIRANË, TË PASURISË 2/29, ME VENDNDODHJE NË
ZONËN KADASTRALE 8280**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, 5 e 17, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin në pronësi të Bashkisë Tiranë, të njësisë administrative Tiranë, të pasurisë 2/29, me vendndodhje në zonën kadastrale 8280, me sipërfaqe 3343 m², sipas planvendosjes, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Bashkia Tiranë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

PLANVENDOSJE

BASHKIA TIRANË

Përgatiti: Specialisti Ing. Topograf
RAIF HALIDINI

RAIF HALIDINI

A. IDENTIFIKIMI I PASURISË

ZONA KADASTRALE: 8280

NR. I PASURISË: 2/29

VOL. 2 FQ. 88

INDEKS HARTE: TR-P-12

SHKALLA: 1:500

ADRESA E PASURISË: Rrethi: Tiranë

Q/F: Tiranë Rr/L: "Parku i Madh"

P/G: _____ Shk: _____ K: _____ Ap: _____

B. KUFIZIMET

VERI: 2/310

JUG: 2/279

LINDJE: 2/275

PERENDIM: 2/279

C. PRONARI

SHTET

D: Data: _____ Ora: _____

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE KRGJSH

KONTURI I PASURISË SË MIRATUAR ME VKM NR. 650, DATË 31.07.2013, PËR
TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË TIRANË.
SIP. TR = 3343 M²

